



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1097/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Pranvera (Loku) Zharku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.1097/2021 i datës 08.11.2021, i kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Pranvera (Loku) Zharku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit 0703D/03R, 0707D/01R, 0707D/02R, 0707D/03R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Pranvera (Loku) Zharku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, në Qendrat e Votimit: 0703D/03R, 0707D/01R, 0707D/02R, 0707D/03R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat Votimeve, të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Pranvera (Loku) Zharku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, me të cilën ka

kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar fletëvotimet në Qendrën e Votimit: 0703D/02R, 0720D/01R, 0720D/02R

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr. 1097/21 (përmes postes te datës 04.11.2021) nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Pranvera (Loku) Zharku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, në të cilën ndër të tjera pretendon se ka pasur parregullsi gjatë numërimit në Qendrat e Votimit të 0703D/02R, 0703D/03R, 0707D/01R, 0707D/02R, 0707D/03R, 0720D/01R, 0720D/02R, për shkak se nuk i janë paraqitur të gjitha votat në rezultatin përfundimtar të publikuara nga KQZ-ja. Apelit si dëshmi i ka bashkangjitur deklaratat e 8 votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit te provave te bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Pranvera (Loku) Zharku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Qendrat e Votimit të lartcekura.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Qendrave të Votimit, të vendosur si ne pikën -II- te dispozitivit te këtij vendimi, nga se rezulton se nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KQZ-së në Qendrën e Votimit 0703D/03R apeluesi ka gjithsej një (1) vota ndërsa si dëshmi në apel ka bashkangjitur shtate (2) deklaratat të votuesve gjithashtu në Qendrën e Votimit 0707D/01R, 0707D/02R, 0707D/03R apeluesja ka gjithsej dy (2) vota të publikuara ndërsa si dëshmi në apel ka bashkangjitur tri (5) deklaratat të votuesve të cilët dëshmojnë se e kanë votuar për kandidaten Pranvera (Loku) Zharku, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratat e votueseve, andaj ka urdhëruar KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibiliteti, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, në vendvotimin 0720D/01R, 0720D/02R ka vetëm një deklaratë ndërsa ka 28 vota ndërsa në vendvotimin 0703D/02R nuk ka asnjë vote dhe asnjë dëshmitar, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm theksime në apel, gjë që pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel. Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankueses se deklaratat e dorëzuar për QV-në e vendosura në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi janë dëshmimi se ka pasur vota në atë QV, poashtu për panelin është e qartë se në këto QV kandidatja në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesja në QV-në e vendosur në pikën IV të dispozitivit nuk i ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka më shumë vota sesa janë publikuar në rezultatit përfundimtarë pasi që të bashkangjitura në apel ka më pak deklarata për këto vendvotime sesa që ka vota të publikuara, prandaj u vendos si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të*

shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1097/2021 më datën 0.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.